
	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-ÇRT-012</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 1 nga 23</i>

21.01.2020

**Azhurnimet vjetore për tarifatat e KOSTT që pritet të hyjnë në fuqi më 1 prill 2020**

**Arsyeshmëri për kërkesat e ndryshimeve të Investimeve Kapitale 2019-2020**

Janar 2020

	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-ÇRT-012</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 2 nga 23</i>

## Përmbajtja:

1.0	Lista e Tabelave.....	2
2.0	Hyrje.....	3
3.0	Të Hyrat.....	3
4.0	Shpenzimet Operative .....	4
4.1	Shpenzimet e Mirëmbajtjes .....	4
4.2	Shpenzimet tjera operative.....	4
4.3	Shpenzimet e Humbjeve në Transmision.....	4
4.4	Shpenzimet e Shërbimeve Ndihmëse .....	5
5.0	Fondi për energjinë e ripërtëritshme .....	7
6.0	Arsyeshmëria për projektet e mos realizuara sipas Planit Investiv 2018-2022 ,(shtyerja e afatit të realizimit).....	7
6.1	Projektet e Realizuara sipas Planit Investiv 2018-2022 .....	7
6.2	Mos realizimi i projekteve për shkak të vonesës në marrjen e lejeve, realizimit të shpronësimit dhe servitutit.....	8
6.3	Grupi i projekteve që nuk kanë filluar me realizim për shkaqe të ndryshme dhe që realizimi bartet në vitet tjera të periudhës 2019-2022 .....	8
6.4	Projektet e reja 2020.....	21
7.0	Përmbledhje.....	23

### 1.0 LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Të Hyrat e Lejuara dhe të Realizuara në vitin kalendarik 2019

Tabela 2. Kostot e kapaciteteve për rregullim sekondar

Tabela 3. Tabela 3. Plani i Implementimit

Tabela 4. Tabela 4. Buxheti i Planifikuar

## 2.0 HYRJE

Zyra e Rregullatorit të Energjisë me datën 9 Dhjetor 2019 ka iniciuar procesin e azhurnimit vjetor të shqyrtimit të tarifave të energjisë elektrike për vitin 2020.

Ky dokument bazuar në Ligjet për Energji të cilat janë në fuqi në Republikën e Kosovës si dhe Rregullat dhe Metodologjitë si pjesë e legjislacionit sekondar ka përcaktuar rrjedhën dhe afatet kohore të këtij procesi.

Bazuar në obligimet që dalin nga Rregulla e Çmimeve për OST/OT-në, KOSTT në vijim paraqet raportin për shpenzimet dhe të hyrat e realizuara gjatë vitit 2019, si dhe kërkesat në këto pozicione për vitin 2020.

Po ashtu paraqiten ndryshimet në Investimet Kapitale sipas Modelit për Përshtatjet e Rregullta Vjetore të ZRRE si dhe arsyeshmërinë për kërkesat e ndryshimeve të Investimeve Kapitale 2019-2020.

## 3.0 TË HYRAT


Në bazë të Vendimit të Bordit të ZRRE-së, me nr. V\_1125\_2019 të datës 28.03.2019, të Hyrat e Lejuara për vitin relevant tarifor 1 Prill 2019 – 31 Mars 2020 për KOSTT kanë qenë 54,196,494 €.

Në tabelën e më poshtëme mund të shihen të dhënat për të hyrat e lejuara dhe të realizuara për vitin kalendarik 2019.

Tabela 1. Të Hyrat e Lejuara dhe të Realizuara në vitin kalendarik 2019

<b>Të Hyrat 2019 Janar- Dhjetor</b>	<b>Njësia</b>	<b>Leujr</b>	<b>Realizuar</b>	<b>Ndryshimi</b>	<b>%</b>
Të hyrat nga 400/220 kV	€000s	568.42	521.05	(47.37)	<b>92%</b>
Të hyrat nga 110 kV	€000s	25,341.74	23,168.39	(2,173.36)	<b>91%</b>
Të hyrat nga SO	€000s	14,126.11	13,278.38	(847.73)	<b>94%</b>
Të hyrat nga MO	€000s	416.32	384.49	(31.84)	<b>92%</b>
Të Hyrat nga BRE	€000s	13,743.89	18,303.44	4,559.55	<b>133%</b>
<b>Total të Hyrat</b>	<b>€000s</b>	<b>54,196.49</b>	<b>55,655.74</b>	<b>1,459.25</b>	<b>103%</b>

Shihet se në total të hyrat e realizuara janë 3% më të larta se ato të lejuara. Kjo ka ndodhur për shkak të të hyrave më të mëdha nga BRE (në të cilat hyjnë 10,901,481 € nga Tarifat dhe 7,401,958 € të hyra nga shitjet me çmimin referent të furnizuesit) krahasuar me ato të planifikuara. Ndërsa shihet që të Hyrat tjera të realizuara të Transmisionit, Sistemit dhe Tregut

	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-ÇRT-012</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 4 nga 23</i>

janë më të ulëta se ato të lejuara për shkak të dallimit në mes të vitit tarifor dhe vitit kalendarik, ku në vitin kalendarik të hyrat për tre muajt e parë janë nga tarifat e vitit të kaluar të cilat kanë qenë dukshëm më të ulëta se sa tarifat e vitit 2019.

Në këtë tabelë nuk janë të përfshira dhe 2,774,635 € të realizuara në emër të Të hyrave për humbje nga përshtatjet e KEK, që në total të Hyrat do të arrijnë 58,430,38 €.

#### **4.0 SHPENZIMET OPERATIVE**

Për vitin 2019 KOSTT i janë lejuar në emër të Shpenzimeve Operative 7,424,537 €. Në kuadër të Shpenzimeve Operative hyjnë Shpenzimet e Operimit dhe Mirëmbajtjes, Shpenzimet e Personelit, Shpenzimet e shërbimeve komunale dhe Shpenzimit tjera operative.

Të realizuara për këtë periudhë janë 7,118,485 €.

##### **4.1 Shpenzimet e Mirëmbajtjes**

Shpenzimet e Lejuara të Mirëmbajtjes për vitin 2019 kanë qenë 1,077,187€. Shpenzimet e Realizuara të Mirëmbajtjes gjate vitit 2019 janë 678,870 €.

##### **4.2 Shpenzimet tjera operative**


Shpenzimet tjera operative për periudhën 2018-2022 janë të lejuara së bashku me shpenzimet e personelit dhe shërbimet komunale. Për vitin 2019 të lejuara kanë qenë 6,347,350 €. Të realizuara për këtë periudhë janë 6,439,615€.

##### **4.3 Shpenzimet e Humbjeve në Transmision**

Niveli i Lejuar i Humbjeve në Transmision për vitin 2019 ishte 1.78% e energjisë se transmetuar për qëllim të konsumit të Kosovës. Kjo e shndërruar në vlerë absolute sipas rrjedhave të parashikuara të energjisë ishte 114.8 GWh. Me një çmim të humbjeve prej 44.88 €/MWh, të hyrat e lejuara për humbjet në transmision për vitin 2019 kanë qenë 5,108,52 €.

Gjendja aktuale sa i përket koston së humbjeve në transmision është si vijon. Niveli i realizuar i humbjeve në transmision është 108.8 GWh i shprehur në përqindje 1.67%, kurse në vlerë financiare 4,564,321€.

Në bazë të Balancës se Aprovuar Vjetore të Energjisë Elektrike, humbjet e parashikuara në transmision për vitin 2020 do të jenë 116.9 GWh në të cilat janë të përfshira dhe 5.8 GWh humbje të tejkaluara, kurse humbjet e sistemit 310 GWh (Konsumi Veriut të Kosovës).

	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-ÇRT-012</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 5 nga 23</i>

#### **4.4 Shpenzimet e Shërbimeve Ndhmëse**

Pas një pune shumë intensive dhe një bashkëpunimi efikas ndërmjet Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT) dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë OST, në Tiranë u nënshkrua Marrëveshja e themelimit të Bllokut Rregullues të Sistemeve Energjetike Kosovë-Shqipëri (Blloku AK).

Operimi si Bllok Rregullues i përbërë prej dy zonave rregulluese KOSTT dhe OST, ka për qëllim operimin më të lehtë të dy sistemeve elektroenergjetike si nga aspekti teknik ashtu dhe ai ekonomik. Kjo do të mundësojë operimin dhe balancimin më të lehtë të të dy sistemeve, zvogëlimin e kostove dhe shkëmbimin e rezervave të sistemeve.

Marrëveshja në fjalë është nënshkruar, në dijeni të ENTSO-E, me pëlqimin e dy rregullatorëve nacional të energjisë ZrRE (Kosovë) dhe ERE (Shqipëri). Kjo marrëveshje është parakusht për operimin e pavarur të KOSTT-it dhe parashihet të hyjë në fuqi në prill 2020, pas nënshkrimit dhe fillimit të implementimit të Marrëveshjes së re të Kyçjes në mes të KOSTT dhe ENTSO-E.

Marrëveshja është po ashtu në përputhje me kërkesat e reja të Kodit të Rrjetit të ENTSO-E që ka për qëllim promovimin e bashkëpunimit të OST-ve (Operatorët e Sistemit të Transmetimit) në funksion të operimit të sigurt të Sistemeve Energjetike si dhe minimizimit të kostove të operimit.

Me këtë, fillon bashkëpunimi i parë konkret i shkëmbimit të rezervave në kuadër të dy tregjeve energjetike Kosovë-Shqipëri me synimin e mëtejshëm për jetësimin e Bursës së përbashkët të energjisë (APEX) në kuadër të së cilës do të mundësohet që edhe palët e tjera tregtare të bëhen pjesë e bursës që do të themelohet së shpejti.

Kjo është marrëveshje historike për Kosovën dhe KOSTT-in, meqë deri më tani ne si KOSTT kemi qenë brenda Zonës Rregulluese serbe (EMS), gjegjësisht brenda bllokut rregullues SMM (Serbi, Mali i Zi dhe Maqedoni e Veriut) dhe tani me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje me OST (Shqipëri) dhe fillimin e implementimit të saj në prill të vitit 2020, definitivisht shkëputemi nga ombrella e Zonës Rregulluese serbe EMS dhe bëhemi pjesë e Bllokut Rregullues me OST Shqipëri, ku me implementimin e kësaj marrëveshjeje rritet dhe garantohet siguria e operimit dhe balancimit të Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës, sipas standardeve të kërkuara nga ENTSO-E.

Në vazhdim mund të shihni disa kalkulime për rregullimin Sekondar dhe Terciar.

Tabela 2. Kostot e kapaciteteve për rregullim sekondar

Kostot e kapaciteteve për rregullim sekondar		
kapaciteti (MW)	ditë/muaj	automatik
37	31	76,253
34	29	65,549
32	31	65,948
29	30	57,838
27	31	55,644
23	30	45,871
24	31	49,461
25	31	51,522
25	30	49,860
28	31	57,705
32	30	63,821
37	31	76,253
Shuma		715,724
<b>Totali ngritje-zbritje</b>		<b>1,431,447</b>

Ndërsa për Rregullimin Terciar varësisht nga marrëveshjet që pritet të bëhen dhe sjellja e çmimeve në treg kemi bërë dy kalkulime për dy versione 190 MW dhe 130 MW. Më poshtë mund të shihni këto kalkulime<sup>1</sup>:


- Në qoftë se do të kemi të kontraktuar kapacitet për rregullim terciar me fuqi prej: P=190 MW dhe me çmim prej 3.5 euro/MW, atëherë për 8760 orë të vitit, kostoja do të jetë:

$$\text{Rregullimi terciar 1} = 8760h * 3.5\text{euro/MW} * 190\text{MW} = 5.825.400 \text{ €}$$

- Në qoftë se do të kemi të kontraktuar kapacitet për rregullim terciar me fuqi prej: P=130 MW dhe me çmim prej 3.5 euro/MW, atëherë për 8760 orë të vitit, kostoja do të jetë:

$$\text{Rregullimi terciar 2} = 8760h * 3.5\text{euro/MW} * 130\text{MW} = 3.985.800 \text{ €}$$

<sup>1</sup> Këto kalkulime mund të ndryshojnë varësisht nga marrëveshjet që pritet të bëhen dhe sjellja e çmimeve në treg.

	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-ÇRT-012</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 7 nga 23</i>

## **5.0 FONDI PËR ENERGJINË E RIPËRTËRITSHME**

Bazuar në legjislacionin që mbulon fushën e energjisë Operatori i Tregut është menaxhues i Fondit për BRE. Llogaritjet për realizimet dhe parashikimet për këtë fond janë paraqitur në Modelin për Përshtatjet e Rregullta Vjetore. Vlera e estimuar për vitin 2020 është 16,789,122 €, ku përfshihet ndryshimi në mes të tarifave nxitëse dhe çmimit mesatar i vitit 2019, kosto e imbalancit 796,250 € si dhe kosto e menaxhimit të fondit që është llogaritur rreth 1% e këtij fondi.

## **6.0 ARSYESHMËRIA PËR PROJEKTET E MOS REALIZUARA SIPAS PLANIT INVESTIV 2018-2022 ,(SHTYERJA E AFATIT TË REALIZIMIT)**

Në përputhje me Marrëveshjen e Kycjes nr.14 të datës 13.01.2011 në mes të KOSTT dhe “Air – Energy” Sh.P.K. – KITKA, pika 13.6, palët me datën 26.12.2019 nënshkruajnë Marrëveshjen e bartjes së Aseteve të Reja të Transmetimit aktualisht në pronësi të “Air - Energy ”Sh.P.K, KITKA tek pronari i ri KOSTT.

Vlera e Aseteve të reja të Kycjes është 1,815,387.86 €, përfshirë pajisjet e ndërtuara në NS Berivojcë dhe linjën 110kV në gjatësi prej 14,8km .

Mirëmbajtja e Aseteve të kycjes do të bëhet në pajtim me Metodologjinë e Taksave të Kycjes në Rrjetin e Transmetimit e aprovuar nga ZRrE.

### **6.1 Projektet e Realizuara sipas Planit Investiv 2018-2022**

#### **a. Projekti ID 021 “Instalimi i Grupeve Matëse në kufirin në mes të KOSTT/KEK/OSSH”**


Projekti ka përfunduar në vitin 2018 dhe është bërë vlerësimi i fundit i realizimit të projektit. Për shkak të situatës politike në pjesën veriore të Mitrovicës, në pamundësi të krijimit të kushteve për punë, realizimit të punëve implementuese në NS Vallaqi dhe HC Ujmani, kjo pozitë është zbritur nga vlera e Kontratës Bazë së Projektit (sipas Price Schedule-it), ndërsa pajisjet e liferuara janë dorëzuar në depon e KOSTT. Në NS Vallaqi zbriten: -19,507.00€ dhe për HC Ujmani zbriten: -12,192.00€

#### **b. Projekti ID 046 “Furnizimi me pjesë rezervë për linjat, vjerrëse dhe shtrënguese, OPGW, joint-box dhe pajisje tjera përcjellëse”**

Në kuadër të këtij projekti janë shpenzuar 150,000.00€ për vitin 2019.

#### **c. Projekti ID 048 “Furnizimi me pjesë rezervë për nënstacione”**

Në kuadër të projektit: Furnizimi me pjesë rezervë për nënstacione janë shpenzuar 241,000.00€ për vitin 2019.

	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-ÇRT-012</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 8 nga 23</i>

**6.2 Mos realizimi i projekteve për shkak të vonesës në marrjen e lejeve, realizimit të shpronësimit dhe servitutit**

**a. Projekti ID/006" Linja e re 110 kV NS Rahovec- NS Theranda"**

Ky projekt është në kuadër të projekteve të financuara nga BERZH (EBRD), i cili ka pas vonesa në marrjen e lejeve për ndërtim, shpronësim dhe servitut, prandaj projekti i paraparë për përfundim në vitin 2019 shtyhet deri në Q2 2020. Vlera e planifikuar e projektit 1,470Mil €.

**6.3 Grupi i projekteve që nuk kanë filluar me realizim për shkaqe të ndryshme dhe që realizimi bartet në vitet tjera të periudhës 2019-2022**

**a. Projekti (ID/049): NS Kastrioti (Ferizaj 3) 110/10(20) kV**


Sqarim: Në analizën ligjore rreth realizimit të shpenzimeve duhet të merret për bazë gjendja faktike se:

- KOSTT nuk ka Bord të Drejtorëve të emëruar që nga data 2 shtator 2018 KOSTT nuk gjendet në situatë të paaftësisë për të paguar – insolvencë;
- KOSTT nuk gjendet në gjendje bankroti - qoftë të shpallur apo pa shpallur, apo procesi të likuidimit - qoftë vullnetar apo të dhunshëm;
- Menaxhmenti i KOSTT ka përgatitur dhe dorëzuar me kohë dhe në afat ligjor Planin e Biznesit dhe Buxhetin për vitin 2019;
- Menaxhmenti i KOSTT në disa raste në mënyrë formale ka kërkuar nga Aksionari që të ndermerren të gjitha masat për emërimin e Bordit të Drejtorëve, duke tërhequr vërejtjen për mungesën e miratimit të Buxhetit dhe Planit të Biznesit, por deri më sot KOSTT nuk ka Bord të Drejtorëve të emëruar.

Duhet të rikujtohet se sipas Nenit 30 të Ligjit për ndërmarrjet publike, Plani i Biznesit miratohet nga Bordi i Drejtorëve deri me 31 tetor të çdo viti kalendarik, për vitin e ardhshëm kalendarik. Plani i Biznesit duhet të analizojë së paku, si vijon: një përshkrim të synimeve afariste dhe financiare të cilat synohen të arrihen nga NP si dhe orarin për realizimin e tyre;

- mënyrat e zgjedhura për arritjen e këtyre synimeve;
- përcaktimin e shpenzimeve të përgjithshme për ushtrimin e veprimtarisë si dhe mënyrës për financimin e shpenzimeve;
- veprimet të cilat duhet të ndërmerren për arritjen e synimeve; dhe
- detyrimet e NP kundrejt konsumatorëve dhe publikut.




	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-ÇRT-012</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 9 nga 23</i>

Këto dispozita përshtatshëmrisht janë reflektuar edhe në Nenin 14.2.2, paragrafin 14.2.2.3, dhe 14.2.2.5 të Statutit të KOSTT, të cilat përcaktojnë se planet investive, planet financiare dhe Plani i Biznesit miratohen nga Bordi i Drejtorëve. Pra, është e qartë se ekziston bazë e qartë ligjore sa i përket përgjegjësisë së miratimit të Planit të Biznesit, ndërsa në anën tjetër Kryeshefi Ekzekutiv ka të drejtë të përfaqësoj kompaninë dhe të lidh kontrata në bazë të autorizimeve të përcaktuara nga Bordi i Drejtorëve viz-a-viz Planit të Biznesit dhe Politikës për Nivelin e Autorizimit, sa i përket investimeve dhe shpenzimeve tjera. Në rrethana normale, të një afarizmi të zakonshëm mungesa e miratimit të Planit të Biznesit dhe Buxhetit do të nënkuptonte mungesën e autorizimit për realizimin e shpenzimeve të caktuara, përveç atyre shpenzimeve të cilat paraqesin detyrime kontraktuale nga vitet e mëhershme, apo të cilat janë autorizuar në mënyrë të rregullt paraprakisht, apo edhe detyrimeve të kontratave të trashëguara nga vitet paraprake dhe kontratave të punës. Në anën tjetër në mungesë të autorizimit të realizimit të shpenzimeve operative KOSTT do të duhej të ndërpresë disa apo të gjitha aktivitetet për përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik (duke njohur ndërvarësinë e funksioneve operative, teknike, financiare dhe ligjore të operimit të KOSTT), pra operimit të sistemit elektroenergjetik dhe operimit të tregut të energjisë elektrike. Kjo situatë, edhe pse përtej përgjegjësisë së vlerësimit ligjor apo këtij vlerësimi të kufizuar, me gjasë të madhe do të ishte në kundërshtim me detyrimet ligjore të ndërmarrjes dhe detyrimet e zyrtarëve të kompanisë, por më e rëndësishmja do të cenonte apo pamundësonte funksionimin e KOSTT dhe të gjithë funksioneve vitale publike në Kosovë, duke njohur funksionin monopolist të KOSTT. Sidoqoftë, edhe nëse KOSTT do të pezullonte disa apo të gjitha funksionet e operimit, duke urdhëruar punonjësit të pezullojnë apo ndërpresin punën deri në autorizimin e shpenzimeve operative në mënyrë të rregullt, KOSTT me gjasë të madhe do të detyrohej që pas rifillimit të operimit të kompensoj të gjitha pagat dhe shpenzimet operative, për shkak të kontratave të punës, dhe detyrimeve tjera kontraktuale-ligjore. Projekti ndërtimi i NS Kastrioti (Ferizaj 3) 110/10(20) kV sipas planit investiv 2018-2022 është paraparë të fillon në vitin 2019 – 2021. Nga stafi i KOSTT është përgatitur specifikimi teknik, por procedurat e prokurimit nuk janë realizuar në mungesë të aprovimit të buxhetit nga ana e Bordit të Drejtorëve. Projekti shtyhet për realizim në vitin 2020 – 2022. Vlera e planifikuar e projektit 5.5Mil €.

**b. Projektet ID (009, 010, 011, 012, 013, 014, 015, 016 dhe 017) e fazës së VI dhe VII -KfW**  
Sipas planit investiv ky grup i projekteve është planifikuar të financohet me kredi nga KfW, përmes shërbimeve konsulentë të përgatitet specifikimi teknik në vitin 2019, dhe realizimi gjatë vitit 2020-2022, por për shkak të mos arritjes së marrëveshjes së kredisë projekti shtyhet.

“Marrëveshja për kredi ndërmjet KOSTT dhe KfW për Fazën VI-VII është inicuar qysh në vitin 2013, ndërsa fillimi formal i nismës për lidhjen e marrëveshjes për kredi është miratuar nga Qeveria e Kosovës me 08.09.2016 me Vendimin Nr. 03/108, ndërsa negociatat formale ndërmjet KOSTT, Ministrisë së Financave dhe KfW janë mbajtur me 13 dhe 14 nëntor 2017. Që nga Dhjetori 2017 për shkak të implikimeve politike në Kosovë si dhe obstrukcioneve nga Serbia për fillimin e operimit të pavarur të KOSTT, vazhdimi i mëtejme i procedurave për nënshkrimin

	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-ÇRT-012</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 10 nga 23</i>

e Marrëveshjes për Kredi për Fazën VI-VII është pezulluar me kërkesë të palës gjermane/KfW, dhe atë deri në qartësimin e pozicionit të KOSTT për operimin e pavarur dhe futjen në operim të linjës 400kV Kosovë-Shqipëri. “

Ky Grup i projekteve shtyhet për periudhën e planifikuar në vitin 2020-2023. Vlera e planifikuar e projekteve faza VI 13.5 Mil € dhe faza e VII 12.00Mil € (pa shpronësim dhe servitut).

**c. ID 053 “Furnizim me 20 copë pajisje Meter Data Collection për nënstacionet distributive 110/x kV”**

Projekti i paraparë për realizim në vitin 2019 shtyhet për vitin 2020.

**d. Projekti ID 055 “Rehabilitimi i NS Prishtina 2 dhe NS Deqani” (Ndërrimi i ndarësve 110kV)**

Ky projekt planifikohet të realizohet gjatë vitit 2020 dhe për shkak të volumit të ndërrimit të pajisjeve vlera i rritet vlera i rritet në 271,000€.

**e. Projekti ID 046.1 “Furnizimi me pajisje për tërheqje të përçuesve dhe përçuesit mbrojtës”**

Projekti - Furnizimi me pajisje për tërheqje të përçuesve dhe përçuesit mbrojtës është shpallur tenderi mirëpo nuk është paraqitur asnjë Operator ekonomik i përgjegjshëm, prandaj ky projekt shtyhet për vitin 2020.

**f. Projekti ID 054 “NS Prishtina 4- Rehabilitimi i Hargjimit vetjak,Ormaneve AC/DC”, Kablllove;**

Projekti -NS Prishtina 4- Rehabilitimi i Harxhimit vetjak, Ormanëve AC/DC, Kablllove është shpallur tenderi ne vitin 2019 asnjë Operator ekonomik nuk ka qene I përgjegjshëm, prandaj pritet të publikohet në vitin 2020.

**g. Projekti ID 056 “Rehabilitimi I kthinave AC 400V”;**


Projekti - Rehabilitimi I kthinave AC 400V kontrata është nënshkruar është ne fazën e implementimit.

**h. Projekti ID 034 “Migrimi drejt sistemeve të avancuara telekomunikuese”**

**Fushëveprimi i projektit:**

Fushëveprimi i këtij projekti është që të fillohet me implementimin e rrjetit optik DWDM dhe/ose MPLS kombëtar/ndërkombëtar duke përdorur infrastrukturën fibër optike ekzistuese të KOSTT-it me lokacione dhe resurse.

**Qëllimi i projektit:** Qëllimi i këtij projekti është:

	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-ÇRT-012</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 11 nga 23</i>

- Të zgjerojë rrjetin ekzistues të telekomunikimeve për të mbështetur më mirë, më sigurt dhe më besueshëm shërbimet e brendshme telekomunikuese,
- Të krijoj të hyra shtesë,
- Si kompani publike është gjithashtu e rëndësishme nxitja e zhvillimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimeve në mbarë Kosovën,

Për realizimin e këtij Projekti nevojiten këto aktivitete:

- Përgatitja e Master Planit për Rrjetin telekomunikues
- Përgatitja e tender dokumentacionit të bazuar në Master Plan
- Vendosja e elementeve aktive të rrjetit
- Integrimi i plotë në rrjetin ekzistues të KOSTT-it
- Integrimi i plotë me rrjetet interkonektive të OST-ve fqinjë.

Për realizimin e këtyre aktiviteteve, medoemos nevojitet një Asistencë Teknike profesionale, e cila u gjet falë iniciativës për Autostradën Digjitale Ballkanike (Balkan Digital Highway) të udhëhequr nga Banka Botërore.

### **Iniciativa për Autostradën Dixhitale Ballkanike**

Kjo iniciativë synon të përmirësojë qasjen në shërbimet brezë gjerë (broadband) me shpejtësi të lartë, në nivel kombëtar dhe rajonal, brenda dhe midis vendeve të Ballkanit, përmes krijimit të një rrjeti rajonal me shpejtësi të gjerë të bazuar në infrastrukturën fibër optike të OST-ve pjesëmarrëse.

Falë rezultateve të këtij Projekti, OST-të do të jenë në gjendje të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe të ofrojnë shërbime interkonektive.

Projekti synon të implementohet përmes nën-projekteve nacionale dhe do të strukturohet brenda tri komponenteve kryesore:


**Komponenta 1:** Asistenca Teknike (AT) për mbështetjen e implementimit të Projektit. Implementimi i Projektit do të bazohet në rezultatet e Asistencës Teknike e cili përfshin: Studimin e fizibilitetit (SF) dhe analizën e kost-benefitit, Dizajnin paraprak, Tender dokumentacionin dhe Dizajnin e detajuar (Master plan).

**Komponenta 2:** Zhvillimi rajonal dhe ngritja e kapaciteteve.

Kjo komponentë do të mbështes implementimin e shërbimeve rajonale për bashkë-shfrytëzimin e infrastrukturës përmes marrëveshjeve rajonale dhe ngritjes së kapaciteteve brenda OST-ve.

**Komponenta 3:** Infrastruktura Dixhitale

**Nënkomponenta 3.1** Bazuar në rezultatet e komponentës 1, projekti do të përqendrohet në nivelin kombëtar të infrastrukturës së OST-ve dhe do të përfshijë implementimin e pajisjeve në nyjet telekomunikuese të rrjeteve kombëtare.

	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-ÇRT-012</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 12 nga 23</i>

**Nënkomponenta 3.2** bazuar në rezultatet e komponentës 1, projekti do të përqendrohet në nivelin ndërkombëtar të infrastrukturës së OST-ve dhe do të përfshijë implementimin e pajisjeve në nyjet telekomunikuese të rrjeteve ndërkombëtare/ndërkufitare të OST-ve pjesëmarrëse.

### Plani i implementimit dhe buxheti

Pas një sërë takimesh, bisedimesh dhe konsultimesh midis OST-ve pjesëmarrëse nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Malit të Zi, nën asistimin e Bankës Botërore u përpilua dokumentacioni për aplikim rajonal në WBIF (Western Balkan Initiative Framework) për një grant për realizimin e synimeve të përshkruara në kuadër të komponentëve të lartpërmendura.

Tabela 3. Plani i Implementimit:


Aktiviteti	Data e fillimit	Data e përfundimit
Nenshkrimi i grantit për Asistencë Teknike	01/2020	02/2020
Pergatitja e Termave të Referencës	12/2019	01/2020
Fillimi dhe përfundimi i aktiviteteve	02/2020	06/2021

Tabela 4. Buxheti i Planifikuar:

Nr.	Përshkrimi	Lloji i shpenzimit	Vlera e parashikuar
			[EUR]
1	Studimi pre-feasibility	Asistencë Teknike	N/A
2	Blerja e tokës		N/A
3	Asistencë Teknike për përgatitje të Projektit (Studimi i fizibilitetit dhe analizat kost-benefit, vlerësimi i in	Asistencë Teknike	261,290
4	Asistencë Teknike gjatë fazës investuese (p.sh. mbikqyrja e punëve, menaxhimi i projektit)	Asistencë Teknike	132,500
5	Punimet (Montimi dhe konfigurimi)	Buxhetore*	397,500
6	Furnizimi	Buxhetore*	2,252,500
7	Komunikimi dhe supervizimi	Asistencë Teknike	26,500
8	Evalimi dhe auditimi	Asistencë Teknike	26,500
9	Asistencë Teknike (Suporti gjatë përgatitjes së projektit dhe mbikqyrja)	Asistencë Teknike	53,000
10	Te pa parashikuara	<=10%	265,000
<b>Total</b>			<b>3,414,790.00</b>

\*Vërejtje : Nëse vlera buxhetore e paraparë për realizimin e këtij Projekti nuk është e mjaftueshme, atëherë parashihet që pjesa e mbetur të realizohet në kuadër të Projektit KODE (Kosovo Digital Economy).

Nga ajo që u tha më lartë, sqarohen arsyet për mos fillimin e realizimit të Projektit: Migrimi drejt sistemeve të avancuara telekomunikuese, sipas Planit për vitin 2019.

	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-ÇRT-012</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 13 nga 23</i>

**i. Projekti ID 032 “Përfshirja e nënstacioneve te reja në sistemin SCADA/EMS në QND dhe QEND”**

Implementimi i projekteve të reja NS Mitrovica 2, NS Drenasi 2 dhe NS Prishtina 6 ka pas vonesa, prandaj kjo ka ndikuar që realizimi i integritit (përfshirjes) së këtyre nënstacioneve në sistemin SCADA/EMS të vonohet. Integrimi (përfshirja) e këtyre nënstacioneve në sistemin SCADA/EMS është ma se e domosdoshme të realizohet gjatë vitit 2020, kjo është kërkesë për plotësimin e kriterëve të KOSTT ndaj kërkesave të ENTSO-E.

Realizimi i këtij projekti përveç që është i lidhur me investim, gjithashtu kërkon kohë dhe staf profesional.

**j. Projekti ID 039 “ Licenca të Microsoft dhe migrimi i sistemit të TIK”**


Pasi që KOSTT posedon sistemin operativ Windows 7 dhe atë Windows server 2008, këto dy sisteme operative nuk do të kenë shërbime që nga data 01.01.2020. Kjo mungesë e shërbimeve të dhëna nga Microsoft do të shkakton pasoja në zhvillimin e proceseve dhe pasiguri në sistem.

Migrimi drejt sistemeve të fundit të Microsoft, mundëson që kompania KOSTT të jetë më e sigurt në operim. Zhvillim dhe lehtësim në përfundim të proceseve.

Në realizimin e migrimit të sistemit TIK në platformën e re të Microsoft, kërkon planifikim, strategji dhe implementim, për këtë arsye ky projekt duhet të filloj sa më parë për arsye që mund të shkakton ngecje në realizimin e punëve periodike dhe pasiguri në integritetin e informacionit të të gjithë punonjësit në KOSTT.

Vija buxhetore për migrim të licencave është parapa në planin 5 vjeçar të dërguar në ZRRE i cili kishte qëllim të fillon që nga viti 2019 deri me 2021 dhe është aprovuar që të realizohet për tre vite.

Ky plan i vazhdimit të migrimit i realizuar për tre vite ka ndryshuar për shkak që sistemet operative që sektori i TIK posedon ato Server dhe Klient kanë pasur mbështetje nga prodhuesi deri në vitin 2020.

	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-ÇRT-012</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 14 nga 23</i>

#### **k. Projekti ID 037 “Rregullimi i Dhomës se Serverëve sipas Standardeve”**

Projektimi dhe ndryshimet ne projekt sipas standardeve aktuale ka kërkuar angazhim te profileve te ndryshme te profesionisteve, qe ka marre një kohe me te gjate se qe ka qene e planifikuar.

Po ashtu puna delikate me projektet e Storage për TIK, ka determinuar një vonese te dukshme, për shkak se ky projekt duhej te implemetohet para rregullimit te dhomës se serverëve për arsye se ne rast dështime te bartjes TIK nuk kishte kapacitet për ruajtjen backup te te dhënave dhe Sistemit.

Ne muajin Dhjetor te vitit 2019 është kompletuar dhe iniciuar kërkesa për tenderim, e cila ka zgjatur 45 ditë, kurse me datën 17.01.2020 kanë arritur ofertat e para te këtij projekti.

Ky projekt i cili është paraparë te filloj në vitin 2019, është përballur me disa faktor te konsiderueshëm te cilët ndikuan drejtpërdrejt në mos realizimin e projektit në këtë vit.

KOSTT ka filluar me shqyrtimin e mundësisë për përgatitje të specifikimit teknik për këtë projekt, është vlerësuar se fillimi i realizimit të projektit “ **Rregullimi i Dhomës se Serverëve sipas Standardeve**” që do të realizohet në selinë qendrore të KOSTT.


Pra, edhe vonesa për fillimin e projektit **Rregullimi i Dhomës se Serverëve sipas Standardeve**, ka ndikuar që ky projekt te shtyhet për vitin 2020.

#### **I. Projekti ID 057 “ Përmirësimi i infrastrukturës së Sigurisë në Selinë Qendrore”**

Në vitin 2017 është aprovuar Ligji Nr. 06/L-014 për Infrastrukturën Kritike. Ky Ligj ka hy në fuqi në vitin 2019. Qëllimi i këtij ligji është për të ruajtur dhe mbrojtur infrastrukturën kritike kombëtare dhe Evropiane. Duke u bazuar në rëndësinë e KOSTT i cili menaxhon Sistemin e Transmisionit të Republikës së Kosovës, duke operuar me nivele të tensionit të lartë 400kV, 220kV dhe 110Kv, rëndësia e aseteve të KOSTT-it është strategjike për Kosovën dhe kërkon një nivel të lartë të funksionimit të tyre, që do të thotë se edhe niveli i sigurisë së aseteve duhet të jetë i organizuar mirë dhe në nivel kualitativ. Siguria e objekteve të KOSTT-it ndikon jo vetëm në operacionet e përditshme për menaxhimin e Operimit të Sistemit të Transmisionit por edhe në shëndetin, mirëqenien dhe sigurinë e punonjësve dhe publikut.

Megjithatë Udhëzimet Administrative që rrjedhin nga ai dhe detajet lidhur me masat që përfshijnë identifikimin e aseteve të rëndësishme, vlerësimin e rreziqeve, si dhe identifikimin, përzgjedhjen dhe prioritizimin e kundërmasave dhe procedurave ende nuk janë të aprovuara.

Gjithashtu gjatë vitit 2019-2020 KOSTT ka planifikuar projektin e sendërtimit të dhomës së serverëve si dhe rehabilitimin e kthinave 0.4kV të cilat në aspekt të hapësirës ndërlidhen me Projektin e Përmirësimit të infrastrukturës së Sigurisë në Selinë Qendrore.

	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-ÇRT-012</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 15 nga 23</i>

Për këto arsye vlera 200,000 Euro e këtij projekti duhet të bartet në vitin 2020 kur edhe do të bëhet realizimi i tij duke e ngritur nivelin e sigurisë në Ndërtesën e Selisë Qëndrore ku është e vendosur Qendra Dispeçerike të përcaktuara si pjesë të infrastrukturës kritike, në harmoni me Ligjin në fuqi.

Ky projekt përfshinë: Përcaktimin e zonave të sigurisë, Funkcionalizimin e Qendrës monitoruese në Ndërtesën e Selisë qendrore ku do të inkorporohen të gjitha kamerat të cilat janë në KOSTT, si dhe të gjitha ato të cilat do të shtohen në të ardhmen, dyert e sigurisë së lartë të cilat kanë të inkorporuar detektorin për metal dhe qelq anti-plumb/ Escape-route CE certified door, RC4 antiburglary and FB3 bulletproof gradës, etj.

#### **m. Projekti ID 037 “ Rregullimi i Dhomës Rezerve së Serverëve - Qendra Emergjente”**

Ky projekt, si pozicion “Rregullimi i dhomes së serverëve” ka qenë në listën e projekteve të lejuara nga ZRrE.

Duke marrë parasysh se kemi paraqitur propozimin në riemërim, në vijim po e paraqesim edhe arsyeshmërinë për këtë projekt.


KOSTT është përgjegjës për planifikim, zhvillim, mirëmbajtje dhe operim të sistemit të transmisionit të energjisë elektrike në Kosovë dhe për këtë qëllim ka të instaluar sisteme të mbikëqyrjes dhe kontrollit të pajisjeve primare të rrjetit të transmisionit si dhe pajisje të tjera që përkrahin punët e përditshme të ndërmarrjes. Këto pajisje janë të prodhuesve të ndryshëm varësisht nga dedikimi dhe projekti me të cilin janë furnizuar.

Gjatë zhvillimit të ndërmarrjes e deri më sot, KOSTT ka zhvilluar dhe prokuruar sisteme të ndryshme, serverët dhe pajisjet përcjellëse të të cilave për arsye të ndryshme objektive janë instaluar në një lokacion jo shumë të përshtatshme për sisteme të një rëndësie të tillë.

Përderisa në objektin kryesor veçse është filluar me përgatitjet për integrimin e të gjitha pajisjeve dhe sistemeve në një Dhomë të Serverëve, sipas standardeve dhe praktikave më bashkëkohore, kjo nuk mund të thuhet edhe për Qendrën Emergjente, e cila është me lokacion në Obiliq tek Kosova B.

Dhoma e Serverëve në Qendrën Emergjente, është një ambient i përshtatur, i cili të vetmin kusht që përmbush për momentin është furnizimi me rrymë elektrike dhe as këtë standard nuk e përmbush sipas normave dhe praktikave më të mira për të ofruar siguri dhe mbarëvajtje të punëve.

Kjo dhomë që në fillim ka qenë paraparë të jetë e përkohshme, ndërsa ndërkohë në vend se të rregullohet, veçse është mbushur edhe me më shumë pajisje të reja.

	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-ÇRT-012</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 16 nga 23</i>

Mungesa e një infrastrukture të veçantë sipas standardeve, vështirëson punën e ndërlidhjes me sistemin kryesor, mirëmbajtjen e pajisjeve dhe po ashtu rrezikon sigurinë dhe operimin e vazhdueshëm të sistemeve emergjente.

Duke analizuar peshën e sigurisë dhe rëndësisë së këtyre sistemeve për KOSTT, si dhe duke pas parasysh që në kushtet aktuale të funksionimit të këtyre sistemeve nuk plotësohen kushtet për siguri të informacionit dhe për certifikim me standardin ISO 27001, gjë që KOSTT e ka vendosur në Objektivat Strategjike të këtij pesëvjeçari, është më se e nevojshme që të ndërtojmë një Qendër Emergjente të Serverëve, e cila do të akomodonte të gjitha sistemet aktuale edhe po ashtu do të ofrojë mundësi për rritje të kapaciteteve.

Qendra e Emergjente e Serverëve do të përmbushë të gjitha standardet ndërkombëtare të cilësisë dhe sigurisë duke përfshirë të gjitha sistemet përkrahëse si klimatizimin, sistemet e mbikëqyrjes dhe alarmimit, sistemin e shuarjes së zjarrit si dhe instalimet elektrike.

Me krijimin e kësaj hapësire të përbashkët, do të krijohen mundësitë që:

- të rritet niveli i sigurisë së rrjetave komunikuese,
- të ngritet niveli i mbrojtjes ndaj qasjeve të paautorizuara
- të ngritet niveli i mbrojtjes ndaj zjarrit, si dhe masat tjera të sigurisë
- të ngritet niveli i rrjetave të brendshme
- të ulen kostot e mirëmbajtjes

Në bazë të vlerësimeve preliminare kostoja e këtij projekti mund të arrijë deri në 300,000.00 Euro, ashtu siç tashmë është e aprovuar në planin investiv 2019 – 2020.

**n. Projekti ID 027 “Pjesëmarrje në RSC (Regional Security Coordination)”**

Gjatë vitit 2019 nuk është aprovuar që KOSTT të veproj si zonë /bllok rregullës prandaj edhe mjetet e parapara nuk janë shpenzuar . Ato kalojnë për vitin 2020 atëherë kur supozohet se do të realizohet që KOSTT të veprojë si zonë/bllok rregullues


**o. Projekti ID 028 “Përshtatja (adaptimi) e softuerit NEPLAN për CIM format” (Upgrade of NEPLAN software for CIM format)**

Gjatë vitit 2019 nuk është bërë përditësimi i softuerit, kjo pritet të bëhet gjatë vitit 2020. Ky projekt është në fazën e tenderimit.

**p. Projekti ID 024 “Kostoja fillestare e themelimit të tregut të përbashkët Kosovë – Shqipëri (APEX)”**

Arsyetim: Mos-themelimi i kompanisë APEX (bursa e përbashkët e energjisë Kosovë – Shqipëri) gjatë vitit 2019.



	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-ÇRT-012</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 17 nga 23</i>

**q. Projekti ID 025 “Rifreskimi i sistemit te menaxhimit te energjise (IT e Tregut)”**

Arsyetim: Në shtator 2018 ka përfunduar kontrata për mirëmbajte nga Siemens.

Duke i pasur parasyshë:

1. Rrethanat e pritura për KOSTT do të operojë si Zonë dhe Bllok i Pavarur Rregullues brenda vitit 2019 në kuadër të Zonës Sinkrone të Europës Kontinentale.
2. Mënyrën e re të realizimit të procesit të skedulimit të Zonë Sinkrone të Europës Kontinentale – implementimi i Platformës për Verifikim për proces të skedulimit dhe balancimit ndërkufitar (bazuar në Politikën 2 të Manualit për Operim të Europës Kontinentale) si dhe
3. Faktit që në kuadër të projektit të paraparë për rifreskim të SCADA-së parashihet edhe integrimi i procesve të skedulimit dhe accountingut – fakt ky e eliminon mundësinë e implementimit si solucion “in house (në kostt)” në afat të shkurtër kohor (brenda vitit 2019).
4. Kërkesat e Grupit PG KOSTT për themelimin e grupit të testimit për KOSTT për të testuar tërë procesin e skedulimit dhe akountingut sipas kërkesave të reja të ENTSO-E. Është bërë huazimi i Sistemit për Menaxhim të Energjisë nga Novita (kompani Sllovene) për tre vjet me një kosto trevjeçare prej 208,860 Euro. Në vitin 2019 janë shfrytëzuar (realizuar) 15,000 Euro.

**r. Projekti ID 026 “Zhvillimi i platformes per ndrrimin e furnizuesit dhe menaxhimin e matjeve”**

Arsyetim: Kushtet e kufizuara si pasojë e vonesave në themelimit të Zonës së Pavarur Energjetike të Kosovës.

**s. Projekti ID 043 “Punimi rrethojës dhe ndriçimit në NS Theranda, SSh Drenas, NS Vitia, si dhe NS Skenderaj, NS Gjilani 1, NS Prishtina 2 /pjesërisht/”**

NS Theranda është një nënstacion mjaft i rëndësishëm në sistemin elektroenergjetik të Kosovës i cili furnizon me energji elektrike qytetin e Therandës dhe fshatrat për rreth.

Në Therandë gjendet edhe një zone industrial mjaft e fuqishme duke marr parasysh rrethanat ekonomike të Kosovës e që gjithashtu kjo zone furnizohet me energji elektrike nga NS Theranda.

NS Theranda si nyje energjetike furnizohet nga 3 linja 110kV dhe bënë transformim të energjisë në nivelin e mesëm të tensionit 35kV dhe 10kV përmes dy transformatorëve, TR1 110/10kV/kV me fuqi 31.5kVA dhe TR2 110/35/10kV me fuqi 31.5kVA

KOSTT viteve të fundit ka bërë investim të madh në këtë nënstacion duke e bërë ndërrimin e pajisjeve të tensionit të lartë 110 kV, pajisjeve të tensionit të mesëm 35kV dhe 10kV si dhe tensionit të ulët si Mbrojtje dhe kontroll.

Pajisjet e montuara janë teknologjia e fundit, ku vlen të ceket se pajisjet 110 kV janë të sistemit GIS.

Me që rrethoja e objektit dhe ndriçimi i sajë nuk kanë qenë pjesë e investimit paraprak, ndërsa gjendja e saj nuk i përmbushë standardet e sigurisë për objekte të kësaj rëndësie të lartë është i domosdoshëm ndërtimi rrethojës së re metalike, të zinkuar, dyerve automatike, monitorimit të hyrjes si dhe ndriçimit të rrethojës sipas standardeve të parapara teknike për NS.



Foto e rrethojës aktuale në NS Theranda



Foto e hyrjes aktuale në NS Theranda

Gjithashtu në vazhdimësi duhet të intervenohet ne punimin e rrethojave të reja në NS Vitia dhe S SH Drenas, dhe të cilat e kanë rrethojën tejet të vjetruar dhe të dëmtuar nga korrozioni, lartësi e cila nuk është e mjaftueshme për objekte energjetike, si dhe mundësia e depërtimit të kafshëve të vogla, mungesa e monitorimit dhe kontrollit nga distanca në dyert hyrëse në NS. Gjithashtu për arsye të ngritjes së nivelit të sigurisë së objekteve është e domosdoshme të parashihet edhe vendosja e ndriçimit përreth tyre. NS Prishtina 2, NS Prishtina 6, NS Skenderaj si dhe NS Gjilani 1 duhet të bëhet vendosja e pjesshme e rrethojës.

Duke u bazuar në gjendjen e prezantuar me lartë si dhe çmimet referente të punëve të ngjashme të realizuara gjer tani kërkesa për buxhet për këto Projekte në periudhën e ardhshme në total është 250.000,00Euro (me tvsh), duke llogaritur që 60% e kësaj vlere të realizohen gjatë vitit 2020.



Foto e rrethojës aktuale në NS Vitia

#### **t. Projekti ID 042 " Renovimi të ndërtesave Komanduese"**

Duke u bazuar në përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të punës, krijimit të ambienteve për punë në të gjitha objektet e KOSTT, si dhe në efikasitetin e energjisë, në këto objekte janë paraparë projektet për renovimin e NS-ve Në kuadër të këtyre projekteve prioritet ju është dhënë eliminimit të materialeve të rrezikshme, pastaj ndërrimit të dritareve dhe dyerve me qelq të njëfishtë duke i zëvendësuar me termike, mbështjellja e fasadave me material termoizolues, largimit të tepisonëve nga sallat komanduese, krijimi i kuzhinave doracake për punëtorët të cilët punojnë në nderime, vendosja e ndriçimit eficient në objekt, furnizimin permanent me ujë të pijshëm për punëtorë dhe ujë për nevoja sanitare, si dhe gjelbërimi i NS në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare

Për këtë qëllim janë paraparë renovimet e Ndërtesave Komanduese duke i klasifikuar sipas prioriteteve.

Ne vitin 2019 është realizuar renovimi i ndërtesave komanduese ne NS Istog, NS Lipjani, NS Deçani dhe NS Prizreni 3.

Në vitin 2020 është planifikuar renovimi i ndërtesës komanduese në NS Besiana, dhe duke e vlerësuar si prioritet krahasuar me gjendjen e ndërtesave komanduese në nënstacionet tjera si dhe renovimi i NS Prishtina 3 dhe NS Gjakova 2, në të cilat gjendja e dritareve ne dhomat e kthinave është e rëndë dhe për këtë kemi shpenzime të mëdha të energjisë elektrike dhe shpesh ka ndodhur edhe rrënja nga puna e NS për shkak te kondensimit dhe lagështisë.

Prandaj, KOSTT vlerëson të domosdoshme të vazhdoj edhe me renovimin e ndërtesave komanduese te theksuara.


Për te realizuar renovimin e ndërtesave komanduese në nënstacionet e theksuara si më lartë, është e paraqitur kërkesa për rritje te buxhetit investime kapitale ne vitin 2020.



Gjendja e dritareve në NS Gjakova 2



Gjendja e dyerve në NS Prishtina 3

	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-ÇRT-012</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 21 nga 23</i>

## 6.4 Projektet e reja 2020

### a. Punimi i depos së mbyllur në Obiliq

Në Obiliq (Kastriot) pranë NS 400kV Kosova B gjendet depoja dhe punëtoria e KOSTT ku deponohen të gjitha pjesët rezervë të nevojshme për intervenimet e rregullta si dhe ato emergjente e të gjitha NS dhe linjave të cilat mirëmbahen nga KOSTT. Gjatë periudhës katërmëdhjetë vjeçare këto asete të KOSTT janë rritur edhe nevoja për hapësira për deponim është shtuar gjithnjë e më shumë.

Përveç kësaj, mos ekspozimi i materialit në depo të hapur, ka qenë shumë herë kërkesë nga punonjësit e KOSTT, por edhe nga ana e kompanisë së sigurimit fizik. Andaj, ndërtimi i një depoje të mbyllur nga konstrukcioni metalik në këtë pjesë do të kishte ndikim pozitiv në shumë aspekte.

Fillimisht, materiali nuk do të ishte i ekspozuar ndaj kushteve të ndryshme klimatike, në aspektin e sigurisë fizike do të ishte më i sigurtë, si dhe menaxhimi i tij padyshim që do të ishte më i kontrollueshëm.


Gjithashtu në vazhden e shtimit të masave të sigurisë nëpër objektet e KOSTT-it, meqenëse si pjesë më e atakuar ka qenë dhe është pjesa e Depos, është e domosdoshme ngritja e nivelit të sigurisë në këtë pjesë. Shpeshherë në pamundësi për t'i sistemuar në depo të mbyllur materialin (pjesët, asetet) me vlerë të konsiderueshme materiale, ato mbesin në hapësirën e depos së hapur, çka edhe paraqet problem si dhe rritë në masë të konsiderueshme gjasat për keqpërdorim, duke mos anashkaluar vjedhjen nga personat e pandërgjegjshëm.

### b. Projekti për funksionalizimin e operimit të Bllokut Kontrollues AK

Bazuar në marrëveshjen KOSTT-OST për implementimin e bllokut kontrollues AK, i cili bllok deri me muajin mars duhet të jetë funksional dhe të fillon veprimin. Në harmoni me këtë marrëveshje dhe obligimet që KOSTT i ka marrë në raport me ENTSO-E, ZRrE, OST dhe bllokun kontrollues AK, KOSTT ka emëruar grupet punuese të cilat së bashku me grupet punuese të OST do të punojnë në detyrat konkrete për implementimin e bllokut kontrollues AK.

Në kuadër të këtyre grupeve është edhe grupi punues për Operim në Kohën reale i cili ka bërë analizë të gjendjes ekzistuese nga këto aspekte:

1. Funksionet ekzistuese dhe aftësitë e aplikacioneve për AGC në anën e KOSTT dhe OST;
2. Forma aktuale e shkëmbimit të dhënave në Kohën Reale KOSTT-OST ;

	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-ÇRT-012</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 22 nga 23</i>

3. Infrastruktura aktuale telekomunikuese KOSTT-OST;
4. Kërkesat që duhet plotësuar në pajtim me marrëveshjen e bllokut kontrollues AK si dhe kërkesat teknike të ndërlidhjes së bllokut me ENTSO-E;
5. Kërkesat teknike të sigurisë kibernetike në përputhje me normat e ENTSO-E ;
6. Ndryshimi i algoritmeve funksionale të AGC për KOSTT dhe OST në pajtim me kërkesat e marrëveshjes KOSTT-OST.

Duke u bazuar në analizat e sipërme del se për realizimin teknik të marrëveshjes për implementimin e bllokut kontrollues në pajtim me kërkesat e parashtruara do të nevojitet një buxhet i cili parashikohet të jetë 100,000.00 € pa TVSh por deri në funksionalizimin e plotë të bllokut shpenzimet e pa parashikueshme mund të paraqiten dhe ky buxhet mund të jetë më i madhe se ai që kërkohen në këtë arsytim.

Duke ditur rëndësinë e implementimit të marrëveshjes për bllokun kontrollues AK në jemi të bindur që kërkesa e jonë do të aprovohet.

**c. Projekti: “Sinjalizimet të Linjat Ajrore për sigurinë e aviacionit”**


Në bazë të rregullores (AAC- Autoritetin e Aviacionit Civil) nr. 03/2019 për shënjimin e pengesave, KOSTT është i obliguar të zbatojë këtë rregullore. Kjo Rregullore përcakton procedurat për shënjimin e pengesave me anë të shenjave vizuale dhe dritave në territorin e Republikës së Kosovës me qëllim që ato të bëhen të dallueshme për avionët dhe helikopterët. Sipas nenit 6 paragrafit 6.1 të rregullores në fjalë vlen:

*6.1 Telat e varur, kabllot, etj., që kalojnë mbi një lumë ose luginë dhe largpërçuesit me tension më të lartë se 100 kV që kalojnë mbi autostradë duhet të shënjohen dhe po ashtu të shënjohen dhe ndriçohen shtyllat e tyre, përveç nëse shënjimi i shtyllave mund të lihet mënjane kur ato ndriçohen nga drita pengesash me intensitet të lartë gjatë ditës.*

Rregullorja definon edhe mënyrën e sinjalizimit të pengesave respektivisht të shtyllave dhe përçuesit mbrojtës të linjës.

Projekti do të zbatohet në faza kohore nga 2020 deri në 2024, pasi që instalimi i sinjalizimit implikon shkyçjen e linjave dhe për këtë shkak kërkon kohë në implementim pasi që hapja e linjave interkonektive të cilat në një masë të madhe kalojnë mbi autostrada dhe rrugët magjistrale bëhet në mënyrë të koordinuar me OST e rajonit.

Projekti bazohet në rregulloren e lartë cekur dhe parasheh që dy shtyllat që lidhin përçuesit të cilët kalojnë mbi rrugët kryesore, apo mbi luginë dhe lumenj duhet të ngjyrosën me ngjyrë bardh/kuq, ndërsa në majë vendoset ndriçimi vezullues. Në anën tjetër në përçuesin

	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-ÇRT-012</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 23 nga 23</i>

mbrojtës vendosën topat sinjalizues me ngjyrë bardh/kuq në distancë të caktuar ashtu që të jenë të dukshme nga pilotët e aeroplanëve dhe helikopterëve gjatë ditës dhe natës.

Në tri nivelet e tensionit 400/220/110 kV janë të evidentuara gjithsejtë 105 kryqëzime me dy autostradat dhe rrugët me 4 korsi që janë të ndërtuara në vendin tone. Linjat 400 kV kryqëzojnë 14 herë, linjat 220 kV kryqëzojnë 13 herë dhe linjat 110 kV kryqëzojnë 78 herë , mbi autostradat dhe rrugët kryesore me katër korsi.

Përfitimet nga Projekti:

- Ngritja e sigurisë së fluturimeve të aviacionit në territorin e Republikës së Kosovës
- Evitimi i aksidenteve fatale të aeroplanëve dhe helikopterëve

## **7.0 PËRMBLEDHJE**

Vlen të theksohet se KOSTT edhe këtë vit ka performancë shumë të mirë në realizimin e investimeve kapitale.

Si rezultat i përdorimit të Operimit Optimal të Sistemit dhe Investimeve Humbjet në rrjetin e transmisionit janë zvogëluar në raport me vitet e kaluara. Nga të gjitha sa u thanë mund të përfundojmë se KOSTT është ndër OST-të më efikase në rajon sa i përket efikasitetit të humbjeve në transmetim dhe performancës së operimit. Benefitet e kësaj performance reflektohen tek konsumatori.

Element tjetër me rëndësi është menaxhimi me sukses i Fondit për BRE dhe Llogaria Balancuese. Të gjitha obligimet e ndërsjella në mes të palëve janë realizuar me sukses dhe pa vonesa.

Gjatë vitit 2020 pritet të implementohet marrëveshja e bllokut KOSTT-OST e nënshkruar me datë 26 Nëntor të vitit 2019. Me implementimin e kësaj marrëveshje Operatori i Sistemit do të kalojë në një mode të ri operimit, ku përfshihen përgjegjësitë e një TSO ndaj ENTSO-E.

Duke marrë parasysh dinamikën e zhvillimeve në sistemin e transmisionit sipas kërkesave nga ENTSO-E është me rëndësi vitale përkrahja e kërkesave për projektet e reja si dhe ndryshimet në ato aktuale. Besojmë se kërkesa e KOSTT do të aprovohet dhe ndryshimet do të përfshihen në të hyrat e lejuara maksimale.